



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik , Komuna e Prishtinës shpallë :

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

POZITA: Zjarrfikës - gjashtë (6) ekzekutues

KOEFICIENTI : 5

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSIA MBIKËQYRËSE :

MBIKËQYRJA: Komandanti i BZP-së, Udhëheqësi i ndërrimit dhe Zëvendës komandantit

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Merr pjesë në intervenimet për fikjen e zjarrit dhe intervenime të tjera;
- Kujdeset për pajisje dhe mjetet e përdorura gjatë intervenimit;
- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë gjatë intervenimit, kur nuk është pronari i pranishëm;
- Rregullisht vijon trajnimet (ushtrimet e caktuara);
- Kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes dhe mjeteve kolektive dhe personale;
- Kryen dhe respekton të gjitha urdhëresat e udhëheqësit të ndërrimit, komandantit ose zëvendësit, përveç atyre urdhëresave të cilat do të ishin vepër kundërvajtës ose penale;
- I kryen edhe detyrat tjera në lëmin profesional;

Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Të jetë nën moshën 30 vjeçare;
- Të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarr fikjes dhe
- Të mos jetë i ndjekur penalisht.

Data e shpalljes së Konkursit : 09.06.2015 deri me dt. 23.06.2015

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e komunës së re.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu qysh parashihet me Ligjin nr.03/L-212 të Punës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranoen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes për pozitat e cekura më lart.

Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopja e dokumentacionit të kualifikimit (diploma e shkollës së mesme), dëshmi për aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarr fikjes, dëshmi që nuk jeni i ndjekur penalisht si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në nr. tel. 038- 233-120.